



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201400579/8

Tiranë ____/____/2014

Lënda: *Rekomandojmë marrjen e masave për zgjidhjen e çështjes së konfirmimit sa më të shpejtë të listës së personave që aplikojnë për përfitimin e ndihmës ekonomike në Bashkinë Leskovik.*

Drejtuar : **Z. Arben DAUTI**
Regjistrues
Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

KOLONJË

Për dijeni: **Z. Ilirjan MUHO**
Kryeregjistrues
Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurisë të paluajtshme

TIRANË

I nderuar zoti DAUTI,

Siç jeni ne dijeni Institucioni i Avokatit të Popullit, në përputhje me paragrafin e parë të nenit 13 të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, nisur nga shkrimi i datës 29.03.2014, publikuar në median elektronike, Balkanweb, me titull "*Bllokohet ndihma ekonomike në Leskovik*", filloi me iniciativën e tij këtë çështje.

Pas marrjes në shqyrtim të kësaj çështje, iu drejtua Drejtorisë Rajonale të Transportit Rrugor, Korçë dhe Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Kolonjë lidhur me moskonfirmimin e listës së personave që aplikojnë për përfitim të ndihmës ekonomike pranë Bashkisë Leskovik.

Në përgjigje të kërkesës sonë, Drejtoria Rajonale e Transportit Rrugor, Korçë, na informoi se nga ana e tyre ishte dërguar lista e automjeteve në pronësi të shtetasve që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike. Ndërsa nga ana e institucionit tuaj u informuam se që të vërtetohet që këta persona kanë pasuri

të paluajtshme të regjistruara pranë ZVRPP-së, duhet të kryhen disa veprime, ndër to edhe arsyeja se Zyra punon në mënyrë manuale dhe jo dixhitale, prandaj edhe ka vonesa në konfirmimin e listave.

Pas marrjes së këtij informacioni, duke qenë se lista me emrat e aplikuesve të ndihmës ekonomike kishte ardhur pranë Zyrës që Ju drejtoni që në muajin Shkurt 2014 dhe kishin kaluar mbi tre muaj, iu drejtuam Bashkisë Leskovik, nëse kishte filluar dhënia rregullisht e ndihmës ekonomike.

Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Leskovik, me shkresën nr.269 datë 19.05.2014, vihemi në dijeni se Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor, Korçë e ka zhblokuar situatën, duke konfirmuar listën e dërguar nga ajo bashki. Ndërsa përsëri mbetet e bllokuar shpërndarja e ndihmës ekonomike për shkak të mospërbushjes së detyrimit ligjor nga ana e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kolonjë, e cila nuk dërgon informacionin zyrtar për konfirmimin e listës së personave që trajtohen me ndihmë ekonomike.

Pavarësisht arsyeve të vonesave për verifikimin e listës për përfitim të ndihmës ekonomike, Avokati i Popullit gjykon se nuk duhet të ketë pengesa nga institucionet shtetërore për t'u bërë shkak i cënimit të të drejtave ligjore të personave që pretendojnë apo trajtohen me ndihmë ekonomike, pra të personave në nevojë.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në pikën, në nenin 52, pika 2, ka përcaktuar se: *“Kushdo, kur mbetet pa punë për shkaqe të pavaruar nga vullneti i tij dhe kur nuk ka mjete të tjera jetese, ka të drejtën e ndihmës ekonomike në kushtet e parashikuara me ligj”.*

Në kuptim të këtij neni, natyra e përfitimit të ndihmës ekonomike për individët të cilët kanë pamundësi punësimi është shprehje e mbrojtjes sociale e realizuar përmes përmbushjes së objektivave sociale dhe si e tillë realizimi i tyre është i lidhur ngushtësisht me detyrimin e shtetit për të bërë të mundur garantimin dhe sigurimin e mjeteve të përshtatshme për nevojat jetësore.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës, ku thuhet shprehimisht se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”, dhe në vijim të nenit 21/b ku thuhet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

R E K O M A N D O J M Ë:

Marrjen e masave për zgjidhjen e çështjes së konfirmimit sa më të shpejtë të listës së personave që aplikojnë për përfitimin e ndihmës ekonomike në Bashkinë Leskovik

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se;

"Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet të shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit",

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI